

VENDIM
Nr. 18, datë 16.1.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s, NR. 241, DATË 15.11.2024**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 1, germa “a”, 144 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16 pika 1 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore, me nr. 121 prot., datë 14.1.2025 “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GEN-I Tirana’ sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 15.11.2023, në pikën 1 të dispozitivit ka vendosur: *1. Detyrimin e publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e krahasimit të çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).*

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. nëpërmjet shkresës me nr. 2052/8 prot., datë 10.12.2024, ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 241, datë 15.11.2024 të Bordit të ERE-s, në bazë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Shoqëria argumenton se propozimi i saj ka për qëllim të diferencojë furnizuesit aktivë nga ata që nuk janë angazhuar në treg, për të parandaluar informacionin mashtrues dhe konfuzionin midis konsumatorëve.

- Sa i përket afateve të parashtrimit të një kërkesë për rishikim të vendimit të ERE rezulton se, kërkesa e shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k është depozituar brenda afatit 7 ditor të parashikuar në legjislacionin në fuqi të sipërcituar.

- Vendimi i Bordit të ERE-s me nr. 241, datë 15.11.2024 i adresohet të licencuarve në aktivitetin e furnizimit. Si subjekt i licencuar nga ERE, shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. ka interes real e vetjak në këtë vendimarrje, ndaj dhe legjitimohet si palë interesi për të ushtruar kërkesën për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s.

- Me qëllim marrjen e vlerësimit të të gjithë furnizuesve në treg të lirë, ERE gjatë seancës dëgjimore të organizuar në datë 19.12.2024, diskutoi mes të tjerave edhe në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024.

- Gjatë seancës dëgjimore iu la detyrë shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. për saktësimin e objektit të kërkesës, sa i përket rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë”.

- Nëpërmjet e-mailit të datës 26.12.2024, shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. ka përcjellë kërkesën e saktësuar, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, duke e mbështetur në nenin 14 të direktivës (EU) 2019/944), për themelimin e PCT. Në këtë kërkesë shoqëria propozon ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2024, si më poshtë:

1. Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike për familjet dhe mikrondërmarrjet me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh nga të licencuarit, të cilët janë të angazhuar aktivisht në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e Krahasimit të Çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).

2. Subjekti i përmendur në pikën 1 është i detyruar të publikojë ofertat e furnizimit dhe të vendosë periudha vlefshmërie për çdo ofertë të publikuar.

- Për shqyrtimin e drejtë të kërkesës së shoqërisë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 14.11.2024, duhet të kalohet në një proces konsultimi të gjerë me palët e interesit për të garantuar mbrojtjen efektive të interesave të konsumatorëve dhe funksionimin e drejtë të tregut. Kjo qasje do të mundësojë mbledhjen e mendimeve nga të gjitha palët e interesit, përfshirë furnizuesit, konsumatorët, ekspertët dhe organizatat e pavarura e veçanërisht ato me fokus mbrojtjen e konsumatorit, duke siguruar një analizë gjithëpërfshirëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024.

2. Fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ndryshimit të pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, si më poshtë vijon:

- pika 1 propozohet të bëhet: *Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike për familjet dhe mikrondërmarrjet me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh nga të licencuarit, të cilët janë të angazhuar aktivisht në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e Krabasimit të Çmimeve të krijuar nga ERE (PCT).*

3. Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë “GEN-I Tirana” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti